



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

VENDIMI KPM V8-2012  
Ref.1210/914KPM/shu

Konform nenit 3, paragrafit 2, nënparagrafit 2.9 si dhe nenit 17, paragrafit 1 nënparagrafit 1.8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve, nr. 04/L-44, Komisioni i Pavarur për Medie (KPM) në përbërje prej Shefki Ukaj - Kryetar, Xhemail Krasniqi - Nënkyetar, Drita Begolli - Anëtare, Nevzat Hydaverdi - Anëtar, si dhe Emrush Kastrati - Anëtar, në mbledhjen e mbajtur me dt.16.10.2012 njerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Konform nenit 46 par.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve nr. 04/L-44, Naile Krasniqi, Kryeshefe Ekzekutive e KPM-së, LIROHET NGA DETYRA.
- II. E përmendura në pikën I të këtij vendimi, e gëzon të drejtën në kompensimin e pagës, deri në përfundim të kontratës së mardhënies së punës.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit, dhe i njëjti do të zbatohet menjëherë.

**A r s y e t i m**

Naile Krasniqi, ka qenë e emëruar kryeshefe ekzekutive e KPM-së, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me dt.30.08.2012 e zgjodhi Komisionin e KPM-së në përbërje prej Shefki Ukaj, Xhemail Krasniqi, Drita Begolli, Nevzat Hydaverdi dhe Emrush Kastrati, ndërsa komisioni i KPM-së, në përbërjen e sipershenuar u konstitua me dt.10.09.2012.

Komisioni i KPM-së, ka konstatuar se me qëllim të zbatimit të nenit 46 par.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve nr. 04/L-44 duhet liruar nga detyra kryeshefen e ekzekutive, për çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media

16.10.2012  
datë

Vednimi i dërgohet:

Arkivit të KPM-së  
Ministrisë së Administratës Publike dhe  
Palëve të përfshira në Vendim